



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit në lidhje me pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, deklaratat hyrëse janë planifikuar të mbahen nesër, më 27 shkurt.

Seanca është planifikuar të fillojë në orën 09:30 dhe të përfundojë në orën 16:00. Atë mund ta ndiqni në internet në tri gjuhët e gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte, përmes transmetimit në faqen e internetit të DHSK-së, me 45 minuta vonësë, ose nga galeria për publikun në ndërtesën e gjykatës në Hagë.

Gjatë deklaratave hyrëse, Prokuroria dhe Mbrojtja do të kenë mundësi të paraqesin përmbledhje të përgjithshme të argumenteve të tyre dhe shpjegim përmbledhës të provave që do të paraqiten. Sipas Rregullores, Mbrojtja mund të vendosë t'i bëjë deklaratat hyrëse menjëherë pas deklaratës hyrëse të Prokurores së Specializuar, apo më vonë, pas përfundimit të paraqitjes së provave nga Prokurorja e Specializuar, ose të mos bëjë deklaratat hyrëse.

Më 27 shkurt, Prokuroria do të bëjë deklaratën hyrëse të saj. Bazuar në parashtrimet publike të deritanishme, Mbrojtja e z. Thaçi dhe e z. Fazliu kanë bërë të ditur se **nuk** do t'i bëjnë deklaratat hyrëse në seancën e nesërme.

Pas deklaratave hyrëse, Prokuroria do të fillojë me paraqitjen e provave dhe do të thërrasë dëshmitarin e parë prej tre dëshmitarëve të vet. Mbrojtja do të ketë mundësi t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të Prokurorisë. Pas deklaratave hyrëse më 27 shkurt, seancat e gjykimit janë planifikuar të mbahen nga 2 deri më 6 mars. Pritet që Prokuroria të përfundojë me dëshmitarët e vet deri më 6 mars.

Prokuroria pretendon se midis së paku 12 prillit 2023 dhe 2 nëntorit 2023, gjatë vizitave të ndryshme të paprivileguara në objektin e paraburgimit, z. Thaçi u dha zotit Smakaj, zotit Kilaj, zotit Fazliu dhe zotit Kuçi, informacion konfidencial për dëshmitarë të thirrur nga Prokuroria në çështjen gjyqësore për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*, i udhëzoi ata që të ndikonin në dëshmitë e dëshmitarëve dhe u dha hollësi se si të vepronin.

Në Aktakuzën e konfirmuar më tej pretendohet se z. Thaçi bashkërendoi tre grupe, të përbëra nga z. Smakaj, z. Fazliu dhe z. Kilaj dhe persona të tjerë për të cilët nuk janë ngritur akuza, dhe nga z. Kuçi, me qëllimin e ndërhyrjes në dëshmitë e dëshmitarëve të thirrur nga Prokuroria në gjykimin aktual për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*.

Të gjithë të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore janë vetëdeklaruar të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.

1

